

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

Dt. 10.03.2025

Ora 11:11

RENDI I DITËS

Shqyrtimi i kërkesës nr.2 të depozituar nga Kuvendi i Shqipërisë me objekt “Kundërshtimi i pikës nr. 1 të vendimit nr. 117, datë 19.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,
z. Ilirjan Rusmali, z. K. Bele, z. Ledio Braho
- **Stafi KQZ:** Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** S’ka
- **Të tjerë:** KRIIK, Znj. K. Rusi (Këshilltare pranë Shërbimit Legjislativ), znj. A.Veshi (Këshilltare ligjore pranë Shërbimit Legjislativ), z.N.Naço (Kryetar i Komisionit të Sigurisë Kombëtare)

Z. I. Rusmali: Mirëdita të gjithëve! Fillojmë seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.2 të paraqitur nga Kuvendi i Shqipërisë, me objekt ankimin e pikës 1 dhe 2 të vendimit nr.117, datë 19.02.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Të pranishëm në seancë janë anëtarët e KAS-it, në përbërje të plotë. Nga ana e ankuesit janë të pranishëm sot, ju lutem prezantohuni.

Znj. K. Rusi, (Këshilltare pranë Shërbimit Legjislativ): Jam Kesiana Rusi, këshilltare pranë Shërbimit Legjislativ.

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

Znj. A. Veshi (Këshilltare ligjore pranë Shërbimit Legjislativ): Jam Antonela Veshi, këshilltare ligjore pranë Shërbimit Legjislativ të Kuvendit të Shqipërisë.

Z. I. Rusmali: Gjithashtu i pranishëm është edhe...

Z. N. Naço (Kryetar Komisioni të Sigurisë Kombëtare): Jam Kryetar i Komisionit të Sigurisë Kombëtare dhe propozues i kësaj nisme ligjore.

Z. I. Rusmali: Deputeti nismëtar i projektligjit që ka qenë objekt shqyrtimi i vendimit nr.117. Nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë të pranishëm Pavlina Doçaj dhe Ina Osmanaj. Ndonjë kërkesë paraprake nuk ka, besoj për përbërjen e trupës, ndonjë kërkesë përjashtimi të ndonjë anëtari të KAS-it nga shqyrtimi i kësaj çështje, nuk ka të tilla. Fillojmë shqyrtimin. Ja japim fjalën ankuesit për të prezantuar, mundësisht shkurtimisht përmbajtjen e ankesës.

Znj. A. Veshi (Këshilltare Ligjore pranë Shërbimit Legjislativ): Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Kuvendi i Shqipërisë, ka ankimuar vendimin nr.117, datë 19.02.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe ka kërkuar shfuqizimin e pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi. Referuar vendimit nr.117 të Komisionerit, konstatohet se: Nga hetimi administrativ rezulton se projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i propozuar nga deputeti z. Nasip Naço” : Është parashikuar për t’u përfshirë në kalendarin e punimeve të Kuvendit për periudhën 10 shkurt - 28 shkurt 2025, u provua se ofron përfitime të drejtpërdrejta për kategori të caktuara të popullsisë, konkretisht të atyre që vuajnë dënimin në sistemin


*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

peniteciar në vend. Ofron rregullim të kuadrit ligjor, duke ju dhënë mundësi më të shpejtë të dënuarve të kalojnë në një institucion me një nivel më të ulët të sigurisë, përfshirë këtu edhe të dënuarit pranë institucioneve të sigurisë së lartë si dhe të kalojnë në regjim të hapur nëse u ka mbetur më pak se 2 vjet e 6 muaj burgim për të vuajtur, duke ndryshuar kushtin prej 6 muajsh që është aktualisht i parashikuar nga ligji në fuqi. Gjithashtu Komisionieri ka parashtruar se : Nxitur nga qëllimi i denoncimit të KRIIK, KQZ shqyrtoi projektligjet, të cilat janë në kalendarin dhe programin e punës së Kuvendit të Shqipërisë, ku është konstatuar se edhe fusha e veprimit të projektligjit, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92, datë 24.07.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, propozuar nga deputeti z. Agron Duka, favorizon një kategori të popullsisë, përkatësisht fermerët të cilët përfitojnë në skemat e pagesave dhe subvencioneve direkte. Ndryshimet e propozuara kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në sektorin ekonomik dhe atë tregtar. Çdo veprim në këtë drejtim mund të dëmtojë parimin e barazisë mes aktorëve ekonomikë në prag të zgjedhjeve, ato mund të krijojnë perceptimin e përdorimit të mjeteve ligjore për qëllime elektorale. Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr.117, datë 19.02.2025 në pikën 1 dhe 2 ka vendosur t’i rekomandojë Kuvendit të mos përfshijë për shqyrtim në seancë plenare projektligjet e sipërcituara. Kuvendi i Shqipërisë vlerëson se pika 1 e vendimit nr. 117, datë 19.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është i padrejtë, i pabazuar në ligj dhe bie në kundërshtim me nenin 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor dhe me nenin 99 të Kodit të Procedurës Administrative si dhe nenin 19 pika 2 të Kodit Zgjedhor me argumentat si më poshtë: Së pari, projektligji nuk sjell përfitime të financiare për të dënuarit sipas parashikimeve të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, por rregullon procedurat e klasifikimit të tyre. Së dyti, për nga natyra aktet që

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

ndalohen duhet të kenë të bëjnë me rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive dhe shpërblimeve, faljen e kamatëvonesave, gjobave, apo detyrimeve tatimore e doganore. Efektet e tij nuk janë të menjëhershme, pasi hyrja në fuqi referuar sugjerimeve të Komisionit të Ligjeve por edhe diskutimeve të bëra në parim në Komisionin për Sigurinë Kombëtare, do të jetë pas zgjedhjeve parlamentare të 11 majit 2025. Gjithashtu ky projektligj nuk është propozuar pas datës 11 janar 2025 dhe as do të zbatohet brenda harkut kohor të ndaluar nga Kodi Zgjedhor. Projektligji është pjesë e një reforme administrative dhe jo një favor elektoral, duke u bazuar në një nevojë të kahershme për përmirësimin e menaxhimit të sistemit peniteciar. Procedura legislative është ndjekur sipas parashikimeve të Rregullores së Kuvendit dhe Kushtetutës, pa përshpejtim të qëllimshëm ose hyrje në fuqi të menjëhershme. Së fundmi, ajo që duam të theksojmë është se vendimi i Komisionerit është i pa mbështetur në ligj edhe për shkak se ai bie ndesh me rregullat në fuqi për formën e aktit administrative, parashikuar në dispozitat e nenit 99 të Kodit të Procedurës Administrative. Akti administrativ i Komisionerit nuk rekomandon, por urdhëron. Rekomandimi nuk ka forcë detyruese, ndërkohë që aktet e Komisionerit, vendimet, urdhërat dhe udhëzimet kanë formë detyruese. Një akt administrativ që është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ është një akt administrativ i paligjshëm, duke u referuar dhe parashikimeve të nenit 109, shkronja “c” e Kodit të Procedurës Administrative. Në lidhje me pikën 2 të vendimit nr 117, datë 19.02.2025 mbi nismën e deputetit Agron Duka, duke qenë se jemi në kushtet kur kjo nisëm është e njëjtë me nismën e depozituar nga deputeti Erjon Braçe, për të cilën Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, në datë 19.02.2025 ka vendosur

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

rrëzimin e vendimit nr. 83, datë 11.02.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vlerësojmë se edhe pika 2 e vendimit nr. 117, datë 19.02.2025 nuk bie ndesh me nenin 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor. Për sa parashtruam më sipër, kërkojmë : Shfuqizimin e pikave 1 dhe 2 të vendimit nr. 117, datë 19.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Faleminderit!

Z. I. Rusmali: Faleminderit! Zoti Naço doni të thoni ndonjë gjë, apo nuk ka nevojë pasi arsyetimi i Kuvendit është i plotë lidhur me ankesën. Administrata e KQZ-së çfarë opinioni ka?

Znj. P. Doçaj: Që të mos biem në përsëritje të atyre që u thanë nga pala ankuese, ne mendojmë që është një vendim i drejtë, vendim i bazuar në hetimin administrativ dhe për më tepër një vendim i bazuar në ligj, ashtu sikundër e kemi shprehur dhe me vendim të zbardhur në pikën 4, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe në vendimin nr.9 të datës 24.12.2020 të Komisionit Rregullator ndalimet dhe propozimet janë të mirëpërcaktuara dhe kanë të bëjnë me miratimin dhe nxjerrjen e akteve ligjore ose nënligjore të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për një kategori të caktuar të popullsisë, të tilla si akte që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive të shpërblimeve. Në aktin administrativ të Komisionerit patjetër që janë të sqaruara në mënyrë të detajuar se pse këto dy projektvendime ose projektvendimi, që është objekt i këtij gjykimi rekomandohet të mos të shqyrtohet në seancë publike. Rekomandimi, nëse do ta përkthenim është një mendim që Komisioneri i jep Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Ne me këtë vendim nuk detyrojmë Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të mos ta marrë në shqyrtim. Një detaj për ju ka të bëjë me kalendarin që vetë Kuvendi na ka vendosur

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

në dispozicion, ku Kuvendi i Republikës së Shqipërisë thotë: kam këtë kalendar shqyrtimesh, çfarë të bëj me të, ne patjetër do të duhet që të shprehemi me një shkresë, me një vendim me e-mail, pra do të duhet që Kuvendit t'i themi ky projektakt është nga ato që ne mendojmë se është në kundërshtim me nenin 91 dhe rekomandojmë që të mos shqyrtohet apo të lihet për shqyrtim në një moment të dytë, apo me shkresë duke ju thënë po të njëjtën gjë. Ne e kemi shprehur me vendim dhe kemi marrë automatikisht vendim administrativ, ku mendojmë që e kemi të bazuar në hetim administrativ, pra në prova dhe në ligj dhe për këtë motiv do të duhet që të rrezohet pretendimi i palës ankuese.

Z. I. Rusmali: Faleminderit! A ka pyetje nga kolegët lidhur me çështjen? Po, zoti Bele.

Z. K. Bele: Juve, jua ka dërguar Kuvendi kalendarin, apo jemi në rastin e shqyrtimit paraardhës kua u kërkua kalendari ose u dërgua...

Znj. P. Doçaj: Në asnjë moment Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk e ka kërkuar kalendarin. Jemi bërë me dije, më saktë kanë dërguar dy herë radhazi kalendarin e punimeve, ku pikërisht kërkojnë nëse mund të vazhdojnë me miratimin e këtyre porojkligjeve apo kemi ndonjë ndalim, i cili buron nga ligji dhe ne pavarësisht se kemi marrë...

Z. K. Bele: Është mundësuar një shkresë e drejtuar nga Kryetarja e Kuvendit..

Znj. P. Doçaj: Po kemi një shkresë nga Kryetarja e Kuvendit bashkëlidhur edhe projektligjet përkatëse.

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

Z. K. Bele: E keni atë shkresë?

Znj. P. Doçaj: Po e kemi. Mund të marrim dhe kalendarin? Ndërkohë e sjell administrata.

Z. K. Bele: Pra juve ju kanë sjellë bashkëlidhur kalendarin, apo ju kanë pyetur lidhur me këtë.


Znj. P. Doçaj: Bashkëlidhur na kanë vendosur dy herë radhazi kalendarin e punimeve. Po, po edhe shkresa përcjellëse. Pavarësisht se ne indicien e kemi marrë nga KRIIK e kemi marrë në shqyrtim atë x gjë, ne kemi edhe një..

Z. K. Bele: E kam të qartë rastin e mëparshëm, por për analogji nëse Kryetarja e Kuvendit ose Sekretari i Përgjithshëm do t'ju sillte në një listë bashkëlidhur, të themi parashikimet për prokurimet publike që ata bëjnë apo për listën e rekrutimit që ata do të bëjnë për qëllime të rekrutimit gjatë vitit, pra mund t'ua dërgonin ata.

Znj. P. Doçaj: Tani qëllimi duhet të jetë i mirëcaktuar. Pse Kuvendi i Shqipërisë më dërgon mua si KQZ kalendarin, ma dërgon për një arsye të caktuar, ma dërgon për të marrë opinionin tim si KQZ për shqyrtimin apo jo të këtij kalendari, se përndryshe nuk ka asnjë funksion tjetër dërgimi i kalendarit në KQZ. Aq më tepër që Kodi Zgjedhor është publik, të gjithë dijnë ta interpretojnë atë...

Z. K. Bele: Ne nuk mund të dijmë aprori pse-në e tyre, mbase po të lexojnë shkresën do kuptojnë më shumë, por në logjikë unë supozoj se të gjitha institucionet e shtetit

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

mund të dërgojnë kalendarët e tyre për aktivitete të ndryshme. Ajo që unë dua të kuptoj është e drejta dhe domosdoshmëria, ose më saktë e drejta dhe detyrimi ligjor që ka KQZ-ja për t'u shprehur, se ju mund tu'a dërgojë kalendarin Këshilli Bashkiak i Tiranës apo i Kuçovës. Fakti që dikush e dërgon një letër, jo domosdoshmërisht i vendos në pozitën që duhet të shpreheni, kështu e kuptoj unë.

Znj. P. Doçaj: Ne në të gjithat rastet kur institucione të caktuar na janë drejtuar me shkresa për interpretim të Kodit dhe të vendimit nr.9 të Rregullatorit pasi kanë pasur qartësi në lidhje me interpretimin e tyre, patjetër që brenda afateve ligjore të përcaktuara që është afati 10 ditor, jemi shprehur me shkresë duke dhënë opinionin tonë për aq sa ne disponojmë.

Z. I. Rusmali: Faleminderit! Po zoti Braho!

Z. L. Braho: Kam një pyetje për administratën në lidhje me nenin 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor, pra këtu po të lexojmë thotë: 4 muaj para ditës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë dhe liston një sërë përfitimesh, që më duket se nuk është listë shtrëuese, pavarësisht se listohen. Po të vemë re bëhet fjalë për akte që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjen ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive, shpërblimeve e tjerë. Nga neni 91, pika 4 duket se bëhet fjalë për përfitime ekonomike, apo mbështetje ekonomike, të gjithë duken sikur janë natyrës ekonomike. Ka ndonjë natyrë ekonomike ky projektligji që ju keni rekomnduar për t'u ndaluar?

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

Znj. P. Doçaj: Ne kemi rekomanduar pikërisht duke interpretuar pjesën e parë të fjalisë, ku thotë: Të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuar të popullsisë.

Z. L. Braho: Bën një listim të kategorive..

Znj. P. Doçaj: Po.

Z. L. Braho: Tani kush është përfitimi dhe a është ekonomik, kjo është pyetja.

Znj. P. Doçaj: Jo vetëm në referim të kësaj pike, por dhe në referim të pikës 3, të nenit 3 të vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator, të cilat kanë shtuar në listën e akteve të ndaluar edhe akte të tjera, të cilat parashikohen në dhënien e përfitimeve dhe favorizimeve për një kategori të caktuar të popullsisë. Ne mendojmë që kjo është një kategori e caktuar e popullsisë dhe ka të bëjë me, nuk e di sesa është sasia e kategorisë, por përveç këtyre vendimi i Rregullatorit ka shtuar edhe kategori të tjera të ndaluara të akteve, të cilat duhet të jenë të ndaluar për favorizim të një kategorie të caktuar. Ne kështu e kemi interpretuar, duke qenë se kemi të bëjmë me një kategori të caktuar do të duhej që ky projektvendim të shqyrtohet në një moment të dytë, rekomandim gjithmonë, jo detyrues sepse Kuvendi i Shqipërisë është një organ i pavarur.

Z. L. Braho: Kam dhe një pyetje tjetër që ka të bëjë me një vendim të Komisionit Rregullator, që është vendimi nr.15, datë 03.03.2025 që është për miratimin e rregullave për krijimin e qendrave të posaçme të votimit, hartimit të listës që ka të

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

bëjë me ngritjen e qendrave në IEVP-të përkatëse duke qenë dhe projektligji. Shoh që në fund nuk është miratuar, sepse nuk ka arritur shumicën e nevojshme. Është bërë ankim nga ndonjë palë në lidhje me këtë, apo është bërë i formës së prerë, 5 ditsh-i ka kaluar?

Znj. P. Doçaj: Më duhet të bëj një verifikim, por në dijeninë time nuk është bërë ankim.

Z. L. Braho: Nuk është bërë ankim?

Znj. P. Doçaj: Nuk është bërë ankim, por më duhet ta verifikoj.

Z. L. Braho: Logjika e mosmiratimit të këtij vendimi është që të gjithë të burgosurit apo të paraburgosurit duhet të bëjnë kërkesa individuale në gjykatë, në mënyrë që ato të votojnë për zgjedhjet e datës 11 Maj 2025. Pra nuk është siç ka qenë në rastet e kaluara që ngriheshin qendrat e posaçme dhe kush nuk cënohej nga Dekriminalizimi, kishte të drejtë të votonte. Në këtë rast duhet t'i drejtohen të gjithë gjykatësve, apo jo, pra nuk është se është një masë shumë e madhe që mund ta parashikojnë tani votuesit që do të votojnë.

Znj. P. Doçaj: Më duhet ta verifikoj, nuk është objekt i këtij gjykimi.

Z. L. Braho: Objekt i këtij gjykimi është duke qenë se me të burgosurit, paraburgosurir kemi të bëjmë.

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

Znj. P. Doçaj: Kemi dy momente të ndryshme, një të përfitimit dhe një të së drejtës së ushtrimit të votës.

Z. L. Braho: Në qoftë se 95 përqind e të burgosurve nuk do të votojnë, a quhen këto 5 përqind-shi i një kategorie të caktuar, që ne duhet të ndalojmë një ligj që prek edhe 95 përqindsh-in?

Znj. P. Doçaj: Një kategori e caktuar, për mendimin tonë ka të bëjë me një kategori që ka më shumë se një person apo një shoqëri dhe quhet kategori më shumë se një.

Z. I. Rusmali: Kolegët, pyetje tjetër? Kam një pyetje. Në kërkesën tuaj ankimore ju referoni tek jurisprudenca e Kolegjit Zgjedhor dhe praktikat administrative të KQZ-së, të cilat sipas jush theksojnë qartë se ndalimi i përdorimit të burimeve publike për qëllime elektorale gjatë periudhës së ndalimit, duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtë dhe të kufizuar. Keni referencë për këtë fjali?

Znj. A. Veshi (Këshilltare ligjore pranë Shërbimit Legjislativ): Për ta saktësuar atëherë i referohemi thjesht vendimit të fundit të KAS në lidhje me projektligjin e cituar nga Administrata e Kuvendit mbi tatimin me vlerën e shtuar.

Z. I. Rusmali: Por jo vendimeve të Kolegjit Zgjedhor, nuk keni vendim të Kolegjit Zgjedhor për të referuar për këtë fjali?

Znj. A. Veshi (Këshilltare ligjore pranë Shërbimit Legjislativ): Jo në fakt. prandaj bëra dhe saktësim.

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

Z. I. Rusmali: Keni pretenduar në parashtrimin e kërkesës ankimore që lidhur me këtë projektligj ka një vendimmarrje ose dakordësi që të ndryshojë dispozita për hyrjen në fuqi. Ku është marrë ky vendim për ndryshimin e dispozitës së hyrjes në fuqi?

Z. N. Naço (Kryetar Komisioni i Sigurisë Kombëtare): Faleminderit! Gjatë diskutimeve në Komisionin e Ligjeve përfaqësues të opozitës shprehën shqetësimin që mund të përdorej për zgjedhjet ky projektligj dhe unë si nismëtar kam qenë dakord që të hynte në fuqi edhe mbas zgjedhjeve në Maj, në Shtator por të miratohej, sepse duhet të kemi parasysh që sot situata në burgje është kjo: ne kemi 5 mijë policë dhe 5 mijë të paraburgosur dhe të dënuar me një kosto financiare vetëm për vitin e kaluar-82 milionë euro. Pra nisur nga kjo kosto e madhe që kemi ne për të dënuarit, kemi dashur të ndërhyjmë për të bërë disa saktësime te Burgu i Sigurisë së Lartë, të Burgu i Sigurisë së zakonshme dhe Burgu i Sigurisë së ulët, padyshim dhe te Burgu i Sigurisë së hapur, pasi vetëm nga këto ndryshimet në buxhet të shtetit do të duheshin më pak të ardhura për këtë numër të dënuarish dhe të paraburgosur dhe gjithashtu dhe për këtë numër tejet të madh të punonjësve të policisë, ne sot kemi këtë kategori ku kemi një polic për një të dënuar. Qëllimi i projektligjit ka qenë që të jetë një polic deri në 5 të dënuar për Burgun e Sigurisë së Lartë, të jetë një polic nga 5 deri në 15 të dënuar për Burgun e Sigurisë të zakonshme, të jetë një polic nga 15 deri në 30 të dënuar për Burgun e Sigurisë së Ulët dhe të jetë një polic për 30 deri në 50 të dënuar te Burgu i Hapur. Ajo që unë do të them dhe kam dashur që ky projektligji të kalonte para viti të e kaluar, ne në Kodin Penal kemi dhe gjysmë lirinë i cili është parashikuar dhe te ligji nr.81 2020 për trajtimin e të dënuarve, por nuk kemi asnjë rast nga gjykata që në vitet e fundit t'i japë vendimet me gjysmë liri. Gjithashtu nëse ne mbajmë këtë projektligj të pandryshuar, janë rreth 500 të dënuar, të cilët duhet të ishin tek Burgu

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

i Sigurisë së Ulët, por rrijnë te Burgu i Sigurisë së Zakonshme. Kjo më shumë ka të bëjë me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sesa ka ndërhyrja apo përfitime nga ana ime apo nga maxhoranca për efekte elektorale. E para, projektligji është depozituar që në datën 23 Dhjetor pra po ta marrim me vit kalendarik 1 vit para, ka qenë e disata herë nga ana ime si Kryetar i Komisionit të Sigurisë Kombëtare, duke i bërë thirrje Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve kur miratohej buxheti që kërkonin vazhdimisht fonde dhe nëse nuk do ndërhynim do të ndërhynim në një grup deputetësh. Kushtetuta parashikon që një grup deputetësh mund të propozojë nisëm ligjvënës në përputhje me Kushtetutën, me rregulloren e Kuvendit kanë propozuar këtë projektligj në Kuvend është bërë para afatit që ndalohet nga ligji, nuk ka përfitime ato që përcakton në ligj, po ta bëjmë një interpretim pastaj e po të shtojmë kategori të caktuar dhe e lemë mbrapa pa e thënë se kush përfiton, më vjen keq por nuk do të doja të zgjatesha në këtë drejtim, nuk doja të zgjatesha dhe në lidhje me vendimin që është marrë nga Komisioneri, kur në ligj parashikohet që merr vendime, urdhëra dhe udhëzime Komisioneri ka dhënë rekomandim, tani të hapim fjalorin dhe të shikojmë se kush udhëzimi dhe kush rekomandimi, unë besoj se nuk dua të merrem me këto terma, them që është brenda afatit ligjor e nuk ka përfitime ligji. Megjithatë dua të them se KRIIK-u ia ka arritur qëllimit, mund ta shtynte këtë projektligj dhe nëse ju do ta miratoni sot, mundësi që të kalojmë nuk ka, ia ka arritur qëllimit dhe mund të them se atë që nuk e bëri opozita e ka bërë KRIIK-u si levë dhe rrip transmisioni, se nuk doli opozita por doli KRIIK-u që ta ankimonte. Shqetësimet e tyre që me 20 apo 50 të dënuar mund të përfitojë maxhoranca që të fitojë zgjedhjet është për të ardhur keq, apo mund të humbasë edhe opozita. Unë mendoj se ky vendim duhet të ishte marrë në kohë në përputhje me ligjin. Thashë se vendimi juaj sido të jetë nuk ka më efekte. KRIIK-u ja ka arritur qëllimeve dhe dua ta falenderoj që e shtyu në kohë, që ne mund të paguajmë dhe më

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

shumë për vitin që vjen, se do kohë nisma ligjore që të implementohet për të hyrë në fuqi. Ajo që mund të them se te burgu i hapur dispozita parashikon deri në 6 muaj, nuk ka mundësi. kam bërë një analizë të hollësishme bashkë me Institutin e Kërkimit Shkencor në Parlament dhe më duhet t'ju them se në 6 muaj kërkesa që është sot duhet 80 ditë që t'i pranohet apo t'i rrëzohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nga Komisioni, për 80 ditë mund të iki në Amerikë, mund të ikë e të bëjë një xhiro rreth botës. Prandaj kam kërkuar të ndërhyj dhe nuk ka të bëjë me efekte ekonomike, por ka të bëjë me të drejtat e liritë themelore të njeriut të këtyre të dënuarve që u cënohen vazhdimisht këto të drejta. Pra ne sot si ai që është dënuar dhe vuan dënimin për një vit dhe ai që është dënuar 20 vjet rri në të njëjtin regjim. sepse nuk bëhet e mundur pa bërë këto ndryshime ligjore. Është në vlerësimin tuaj për të marrë vendimin e duhur, por thashë vendimi juaj sido që të jetë, KRIIK-u ia ka arritur qëllimit. Faleminderit!

Z. I. Rusmali: Faleminderit zoti Naço. Unë ndoqa regjistrimin e seancës në Komisionin e Ligjeve, por nuk munda të konstatoj që në Komisionin e Ligjeve janë bërë propozime formale për amendimin e nenit për hyrjen në fuqi. Raporti ndërkohë i Komisionit të Ligjeve është bërë publik?

Z. N. Naço (Kryetar Komisioni të Sigurisë Kombëtare): Faleminderit! Komisioni i Ligjeve është komision për dhënie mendimi, nuk ishte komision përgjegjës. Raporti do të vinte në Komisionin e Sigurisë Kombëtare dhe aty do bëhej dhe ndryshimi përkatës në amendament nga ana ime si nismëtar. Kështu që raporti nuk ka të bëjë, unë kam qenë dakord nga pyetjet e opozitës për të hyrë në fuqi pas zgjedhjeve, nëse ata mendonin që ne do të përfitonim në mënyrë elektorale.

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

Z. I. Rusmali: Fati i këtij projektligji me sa duket, thoni ju nuk do të zgjidhet para zgjedhjeve, do të jetë një çështje që do t'i përkasë Parlamentit që vjen, kjo për shkak se ndërkohë janë ndërprerë seancat plenare?

Z. N. Naço (Kryetar Komisioni të Sigurisë Kombëtare): Nuk e thashë në këtë kuptim, ne mund të kemi një ose dy seanca sipas programit dhe kalendarit, pastaj ndërpritet Parlamenti për të kaluar në fushatë elektorale. Do të kthehemi në datën 20 Maj e do të vazhdojë deri në fund të Korrikut. Nuk thashë se do të jetë për parlamentin tjetër është shtyrë për këto kohë, por nëse ne nuk e miratojmë deri në fund do të duhet që buxheti i vitit tjetër talakojë fonde të tjera, se buxheti miratohet në muajin Dhjetor, dhe do të duhet edhe një vit tjetër që ne taksapaguesit shqiptar të paguajnë 80 milionë euro, pa e kuptuar dhe vetë se ku venë këto lekë. Faleminderit!

Z. I. Rusmali: E qartë do të thotë para zgjedhjeve nuk ka shanse, por pas zgjedhjeve mund të jetë në shqyrtim.

Znj. A. Veshi (Këshilltare ligjore pranë Shërbimit Legjislativ): Së pari më lejo të sqaroj diçka që raporti i komisionit të Ligjeve është bërë publik, është i publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit.

Z. I. Rusmali: I ka të dhëna?

Znj. A. Veshi (Këshilltare ligjore pranë Shërbimit Legjislativ): Nuk ka qenë amendament, por ka qenë sugjerim, pra Komisioni shpreht me amendamente dhe sugjerime.

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

Z. I. Rusmali: Në raport sugjerimi është i përfshirë?

Znj. A. Veshi (Këshilltare ligjore pranë Shërbimit Legjislativ): Është përfshirë sugjerimi tek pjesa e disuktiveve të komisionit për çështjet ligjore.

Z. I. Rusmali: Faleminderit. Për administratën e Kuvendit ju na sollët shkresën e Kuvendit, të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, në të cilën ju ka vënë në dijeni për kalendarin. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit në këtë shkresë si referencë ligjore për nevojën e kësaj shkrese jep pikën e parë të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, domethënë në këndvështrimin e Kuvendit ata kanë qenë duke raportuar sipas mënyrës së tyre veprimtaritë publike, nuk kanë qenë duke përcjellë kalendarin me qëllim që ju ta shqyrtonit atë dhe të mund të jepnit opinion për cilat ligje, projektligjet duhen të kalojnë e cilat jo. A e lexoj drejt apo e lexoj gabim unë këtë referencë?

Znj. P. Doçaj: Në lidhje me referencën e përdorur nga Kuvendi dhe jo vetëm shkresërisht por jemi dëgjuar me përfaqësues të Kuvendit edhe me e-maile apo në mënyrë telefonike, kanë dashur pikërisht këtë, sepse mënyra e raportimit në KQZ për veprimtaritë publike nuk bëhet në këtë formë. Pra kemi një portal, një ndërfaqe elektronike të miratuar me një vendim të Komisionerit ku çdo veprimtari publike deklarohet në këtë ndërfaqe.

Z. I. Rusmali: Do të thotë në leximin tuaj referenca te pika 1 e nenit 92 është lapsus i Sekretarit të Përgjithshëm?

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

Znj. P. Doçaj: Nuk e di a është lapsus, nuk mund ta them këtë, por nuk ka asnjë veprimtari publike në këtë rast që do të duhet të deklaronim si të tillë.

Z. I. Rusmali: Sekretari i Përgjithshëm ka shkruar: I nderuar zoti Komisioner, në zbatim të pikës 1 të nenit 92, pika 1 e nenit 92 bën fjalë për raportimin e veprimtarive publike. Veprimtaritë publike të institucioneve publike në fushatë të ligjit nr.10 019, datë 28.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar. bashkëplidhur po ju dërgojmë programin dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit në periudhën 10 Shkurt-28 Shkurt miratuar me vendimin e Kuvendit nr.3, datë 30.01.2025 ka dhënë këtë referencë. Veprimtari e institucioneve publike në fushatë pika 1 e nenit 92, nuk ka thënë në zbatim të pikës 4 të nenit 91 po ju dërgojmë projektligjet që ju mund të jepni rekomandimet tuaja. Ju pse e lexuat kështu?

Znj. P. Doçaj: Ne e kemi lexuar në këtë formë dhe pas indicieve të KRIIK, i kemi marrë në shqyrtim edhe projektvendimet e tjera pikërisht për t'i dhënë një rekomandim Kuvendit se kush janë ato që do të përbënin një ditë shkeljen e tyre dhe më pas aplikimin e sanksioneve në rastet e tejkalimit të nenit 92 dhe 91 të Kodit Zgjedhor.

Z. I. Rusmali: Kur Komisioneri ka marrë vendimin nr.117, KAS-i nuk kishte nxjerrë vendimin e tij nr.1, me të cilin ka adresuar intepretimin ligjor të dispozitës dhe rastet kur mund të ndodhin në kushte të ndalimit dhe raste kur nuk ndodhemi dot në kushte të ndalimit. Për më tepër ka bërë dhe analizën ligjore nga këndvështrimi i tij, të natyrës që duhet të ketë dispozitivi i një vendimi si akt përmbyllës i një procedure hetimore administrative. Vendimi i Komisionerit si duhet të formatohet urdhërimi pjesa urdhëruese e vendimit me qëllim që ajo të jetë në përputhje me Kodin e

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

Procedurës Administrative. Nga ana tjetër KAS-i me këtë vendim ka bërë dhe analizën ligjore të rastit, ndryshimeve në ligjin për tatimin në vlerën e shtuar. Nga këndvështrimi i kësaj, unë po e quaj jurisprudence ju nuk keni ende asgjë për të ndryshuar tek pozicioni juaj institucional, i qëndroni gjithçkaje që është në vendimin nr.117?

Znj. P. Doçaj: Po i qëndrojmë pasi vendimi ka të bëjë me shqyrtimin administrativ për denoncimin nr.6 të regjistruar të denoncuesve të KRIIK, ku kërkues është KRIIK dhe subjekt i denoncuar është zonja Elisa Spiropali dhe zoti Engjell Agaçi. Pra nuk lidhet me shqyrtimin e veprimtarisë së Kuvendit, lidhet pikërisht me shqyrtimin e këtij denoncimi. Si rrjedhojë e këtij denoncimi kemi marrë në shqyrtim edhe projektvendime, të cilat ne i kemi rekomanduar më pas Kuvendit, kemi dalë me atë dispozitiv.

Z. I. Rusmali: Atëherë mbylлим këtu seancën e pyetjeve dhe japim mundësinë që të shfaqnit pretendimet tuaja përfundimtare, para se ne të marrim vendimin.

Znj. A. Veshi (Këshilltare ligjore pranë Shërbimit Legjislativ): Atëherë përfundimisht ne i qëndrojmë objektit të ankimit tonë, thjesht për të sqaruar ndoshta dhe përfaqësuesit e administratës së KQZ-së në lidhje me sa u diskutua. Dua të them se në parashtrimet e veta Komisioneri në vendimin nr.117 nuk i është referuar në asnjë rast shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Shqipërisë, por konkretisht ka cituar se, nisur nga qëllimi i denoncimit të KRIIK, KQZ shqyrtoi projektligjet të cilat janë në kalendarin dhe programin e punës së Kuvendit. Së dyti dua të them që kalendari i Kuvendit nuk është informacion i klasifikuar është publik pra në momentin që miratohet në seancën plenare, publikohet në faqen zyrtare të

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

Kuvendit. Së treti, në lidhje me interpretimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor ku përfaqësuesja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve tha që kam lexuar vetëm një pjesë të dispozitës, ose kam interpretuar atë pjesë, thjesht për ta sqaruar duke qenë ne si Kuvend jemi hallka e fundit e procesit legjislativ, dispozitën ne e kemi lexuar në tërësi të saj jo vetëm një pjesë, pra dhënia e përfitimit për kategori të caktuar të popullsisë që parashikojnë dhe ndikimi duhet të jetë gjithmonë me rritje ekonomike, të paktën mënyra sesi ne e lexojmë nenin 91 të Kodit Zgjedhor. Përfundimisht i qëndrojmë kërkesës së bërë.

Z. I. Rusmali: Faleminderit! Administrata e KQZ-së?

Znj. P. Doçaj: Në referim sa u shtua nga Kuvendi, u bëj me dije që e kemi lexuar dispozitën në tërësi të tij, kemi lexuar dhe vendimin e Komisionit Rregullator që ndoshta nuk është lexuar nga të gjithë. se cilat janë ato kategori dhe listë kategorish të cilat ky vendim i shton, pra i përforcon. Ne mendojmë që edhe në këtë rast dhe sidomos duke u referuar pikërisht në ligj, në nenin 4 të tij, citohet në mënyrë eksplicite se cilat janë përfitimet që do të ketë kjo kategori. Pra është një kategori e të dënuarve të cilët janë të dënuar nga 6 muaj deri në 2 vjet dhe kontratat e punës që këtyre të dënuarve do t'u siguroheshin, që dhe këto përkthehen në para në dijeninë time. Në lidhje me kalendarin e vendosur në dispozicion nga Kuvendi, theksojmë përpara jush që siç e theksova në shqyrtim kemi pasur denoncimin e KRIIK, prandaj jemi referuar tek denoncimi KRIIK për t'i qëndruar strikt pikërisht depozitimit të kësaj ankese ndaj miratimit të këtyre projektvendimeve. Kemi marrë në shqyrtim më pas edhe dy projektvendime të tjera, duke qenë se kalendarin na e ka vendosur në dispozicion Kuvendi i Shqipërisë. Në rast se nuk kanë qenë të informuar për mën

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

yrën sesi do të duhet të deklaronin në ndërfaqen elektronike të KQZ-së, apo në zbatim të vendimeve dhe akteve nënligjore që KQZ ka nxjerrë, nuk është për fajin tonë. Ne mendojmë që vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është në përputhje me provat dhe me ligjin dhe i kërkojmë KAS-it që ta lejë në fuqi atë.

Z. I. Rusmali: Faleminderit!

Znj. A. Veshi (Këshilltare ligjore pranë Shërbimit Legjislativ): Më lejoni edhe diçka të fundit, thjesht për të sqaruar diçka në lidhje me vendimin nr.117 të Komisionerit, ne kemi konstatuar që objekti nuk është konform edhe vendimit. Pra objekt ka qenë marrja e hapave për parandalimin e shtrirjeve të efekteve të projektligjit për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.81 2020, ndërkohë që vendimi i Komisionerit ka rekomanduar përveç këtij ligji edhe projektligjin tjetër që ka qenë projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92 datë 24.07.2014.

Z. I. Rusmali: Faleminderit!

Znj. P. Doçaj: Objekti është pikërisht objekti i denoncuesit, po të jemi pak të vëmendshëm dhe të shohim denoncimin e paraqitur nga KRIIK pikërisht këtë ka objekt, marrja e hapave të nevojshëm për parandalimin e shtrirjeve të efekteve të X projektligji, tjetër gjë është që hetimi kryhet nga ana jonë, por objekti i denoncimit ky është dhe ne i qëndrojmë strikt atij.

Z. I. Rusmali: Faleminderit! E mbyllim këtu shqyrtimin për të kaluar në vendimmarrje. Besoj se ne temën në përgjithësi e kemi trajtuar me një vendim tjetër,

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.03.2025*

këtu me njëri-tjetrin duhet të trajtojmë veçoritë që ka ky rast. Mblidhemi në orën 12:00 për shpalljen e vendimit. Faleminder

Rifillon Mbledhja

Ora 12:02

Z. I. Rusmali: Atëherë riçelim seancën për shpalljen e vendimit të KAS-it, lidhur me kërkesën ankimore nr.2 të paraqitur nga Kuvendi i Shqipërisë mbështetur në nenin 21, pika 1 shkronja “b” të ligjit nr.10 019 datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor të ndryshuar, Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosi: Pranimin e kërkesës ankimore nr.2 datë 21.02.2025 të depozituar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Shfuqëzimin e vendimit nr.117, datë 19.02.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr.49 2012, për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative të ndryshuar.

Mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 45 ditëve nga njoftimi i tij. Njoftuar palëve të pranishme me shpalljen u shpall sot me datë 10.03.2025. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr.14

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*

